

Draft propozimi për disa ndryshime në Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE. Procedurë e filluar me vendimin nr. 169 datë 26.10.2017 të Bordit të ERE

- **Në nenin 2 “Qëllimi i rregullores”**: pas fjalëve, *...e energjisë elektrike...* të shtohen fjalët, *“apo të gazit natyror”*

Në nenin 5 “Përkufizime”:

- **Pika 9 “Licencë”**: Në fund të paragrafit pas fjalëve, *...”Për gazin natyror” si dhe...* të hiqen fjalët *“procedurat e licencimit të ERE-s”* dhe të shtohet vijimi i paragrafit me: *...“ligjit nr. 102/2015, “Për gazin natyror” si dhe “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike ose /dhe Rregullat dhe procedurat për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror.”*
- **Pika 11 “Klienti”**: Në fund të fjalisë të shtohet, *“..., ose një subjekt që blen me shumicë gaz natyror, me qëllim rishitjen brenda ose jashtë sistemit ku është i lidhur ose klienti fundor i gazit natyror, si dhe çdo subjekt tjetër i gazit natyror që blen gaz natyror”*
- **Pika 12 “Klient Familjar”**: Në fund të fjalisë të shtohet, *“..., ose që blen gaz për konsum familjar dhe jo për veprimtari tregtare ose profesionale.”*
- **Pika 13 “Klient Fundor”**: Në fund të fjalisë të shtohet, *“...,ose që blen gazin natyror për përdorim vetjak.”*
- **Pika 14 “Klient jofamiljar”**: në fund të fjalisë të shtohet, *“..., ose personat fizikë ose juridikë që blejnë gaz natyror, i cili nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.”*
- **Pika 15 “Klient i vogël jofamiljar”**: në fund të fjalisë të shtohet, *“..., ose shoqëria, e cila ka të punësuar 6 deri në 20 punonjës, ka xhiro ekonomike vjetore, e cila nuk kalon shumë në 150 milionë lekë dhe që blen gaz për përdorim vetjak dhe jo për qëllim rishitjeje.”*
- **Pika 16 “Klient shumice”**: në fund të fjalisë të shtohet, *“..., ose personi fizik ose juridik, i ndryshëm nga OST-ja ose OSSH-ja, i cili blen gaz natyror, me qëllim rishitjen brenda ose jashtë sistemit ku është i lidhur.”*
- **Pika 17 “Klient në nevojë”**: në fund të fjalisë pas fjalës *“...përcaktimeve...”* të shtohet, *“..., të ligjit 43/2015 ose klienti familjar, i cili, për shkak të gjendjes sociale, gëzon disa të drejta të veçanta, lidhur me furnizimin me gaz, të siguruar në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të ligjit 102/2015.”*

Draft propozimi për disa ndryshime në Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE. Procedurë e filluar me vendimin nr. 169 datë 26.10.2017 të Bordit të ERE

- **Pas pikes 20 “Aplikues”**, të shtohet edhe një pikë tjetër “Aplikim” me përmbajtjen: *“Aplikim” do të thotë e drejta e një personi për të paraqitur një kërkesë që është në autoritetin e ERE pasi ka shlyer detyrimet ndaj ERE.*
- **Pika 31 “Aktivitete të rregulluara”**: në fund të fjalisë të shtohet, *“...apo ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror.”*
- **Të shtohet edhe Pika 32**, me përmbajtje: *“Termet e tjerë të përdorur në këtë rregullore do të kenë kuptimin e parashikuar në ligjin për Sektorin e energjisë elektrike apo atë të gazit natyror.”*

Në nenin 18 “Rregjistrimi i aplikimit apo kërkesës”, të shtohet një pikë (1.) me përmbajtje: *“1. Subjekti aplikues, nëse është një i licencuar, duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE, si pagesë rregullimi, masë administrative, etj përpara se të kërkojë rregjistrimin e procedurës për të cilën aplikon pranë ERE.”*

Në nenin 20 pas pikes 3 shtohet:

1. *Nëse kërkesa e një aplikuesi që kërkon të licensohet, rinovojë licencën, modifikojë apo transferojë atë, rrezohet nga Bordi i ERE për shkak të mangësive në dokumentacion, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet ERE-s jo më vonë se 1 muaj nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurave, duke plotësuar dokumentacionin dhe pagesën për mangësitë për të cilat është rrezuar vendimi. Dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm si dhe pagesa e aplikimit do të konsiderohet e vlefshme dhe Bordi do të shprehet me vendim mbi dokumentacionin e pagesën e aplikimit fillestar dhe atë të plotësuar.*